

Prokurat

Ambasada mund të përpilojë prokura të thjeshta për autorizim përfaqësimi për veprime të thjeshta që nuk synojnë lindjen, ndryshimin ose shuarjen e të drejtave dhe detyrimeve të të përfaqësuarit. Nga ky shërbim që ofrohet nga Ambasada, përfitojnë vetëm shtetasit shqiptarë me banim e qëndrim të rregullt në Austri.

Për t'u pajisur me prokurë, shtetasi duhet të paraqitet detyrimisht në Ambasadë. Duhet të paraqesi pasaportën e vlefshme shqiptare ose kartën e identitetit, si dhe dokumente të mjaftueshme që tregojnë se ka qëndrim të rregullt në Austri. Gjithashtu duhet që të dihen me saktësi edhe të dhënat e personit të autorizuar: përveç emrit, vendlindja, datëlindja, adresa, numri i pasaportës ose kartës së identitetit.

Tarifa për përgatitjen e prokurave në Ambasadë është 20€/faqe. Pagesa për tarifën duhet të bëhet paraprakisht në llogarinë e ambasadës për shërbimet konsullore.

Duhet pasur parasysh që Ambasada nuk mund të lëshojë prokura që kanë të bëjnë me ndryshim e pronësie, si p.sh. veprime që kalojnë pronësinë mbi pronat e paluajtshme, dhe prokura që kanë të bëjnë me detyrime nga kontratat. Këto prokura mund të porositen vetëm te noterët e licencuar në Austri. Paraqitja pranë një noteri austriak mund të shkohet edhe si zgjidhje alternative, nëse ardhja në Ambasadë është e pavolitshme.

Prokurat e lëshuara nga noterë austriakë kanë nevojë për Vule Apostile ([link](#)) në mënyrë që të njihen në Shqipëri (shih: Vule Apostile)